



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS, E MBAJTUR 20 SHTATOR 2018**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 20. SEPTEMBRA 2018. GODINE**

**SHTATOR - SEPTEMBAR  
2018**

## **Rendi i ditës**

1. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian,
2. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-094 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin “Evropa për qytetarët”,
3. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-095 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në “ERASMUS +” Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport,
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-099 për aderimin e Kosovës në Marrëveshjen për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA).

## **Dnevni red**

1. Glasanje o Nacrtu zakona br. 06/L-090 o ratifikaciji Finansijskog sporazuma za IPA 2017, prvi deo, između Kosova i Evropske unije,
2. Glasanje o Nacrtu zakona br. 06/L-094 o ratifikaciji Sporazuma između Kosova i Evropske unije o učešću Kosova u program “Evropa za građane”,
3. Glasanje o Nacrtu zakona br. 06/L-095 o ratifikaciji Sporazuma između Evropske unije i Kosova o učešću Kosova u “ERASMUS +” Program unije za obrazovanje, obuku, omladinu i sport,
4. Razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-099 za pripajanje Kosova u Sporazumu za osnivanje Regionalne škole javne uprave (ReSPA).

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Kisha kërkuar nga kryetarët e grupeve parlamentare që deputetët të vijnë në sallë, për arsye se është seancë e jashtëzakonshme, na duhen 2/3, do të thotë jemi 52 deputetë, e duhen 80.

Fillojmë pas 10 minutave, në 14:30 po presim, në momentin që bëhen 80 deputetë, ne e fillojmë, të paktën të mos e lëmë pezull seancën.

\* \* \*

Të nderuar kolegë deputetë,

Ka 102 nënshkrime tek administrata, ndërkohë janë vetëm 77 deputetë, në mënyrë elektronike.

84 deputetë janë, është duke u ngritur numri, 86. Po e fillojmë seancën.

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kryeministri është në ardhje, tani sa lajmëroi nga Drenasi.

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës me kërkesë të 53 deputetëve të Kuvendit.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 95 deputetë.

Të nderuar deputetë,

Para se të fillojmë me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, ju njoftoj se Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa, në bazë të nenit 42, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit ka propozuar që rendi i ditës të kësaj seance të plotësohet edhe me tri pika shtesë:

*1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për huan ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për investime të projektit të autostradës Prishtinë-Pejë, segmenti Kijevë-Zahaq,*

*2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës lidhur me programin mbështetës për ujësjellësin dhe kanalizimin në zonat rurale, faza e gjashtë, dhe*

*3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për financim mes Republikës së Kosovës dhe asociacionit ndërkombëtar për zhvillim për projektin e ekonomisë digjitale të Kosovës*

Komisioni ka propozuar që shqyrtimi i këtyre projektligjeve të bëhet me shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 15, paragrafi 7 dhe me nenin 56, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit.

Ndërkohë paraprakisht, para fillimit të seancës, e ka kërkuar fjalën Ismajl Kurteshi, ka edhe një propozim në emër të komisionit, po ashtu për pikë të rendit të ditës. Urdhëro, i nderuar deputet!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

Më lejoni që në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Inovacione dhe Ndërmarrësi të propozoj plotësimin e rendit të ditës së mbledhjes plenare të Kuvendit të datës 20 shtator 2018 me pikën si në vijim:

*- Shqyrtimi i Projektligjit numër 06/L-102 për ratifikimin e Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në programin 'Evropa kreative' për mbështetjen e sektorëve kulturorë dhe kreativë.*

Duke pasur parasysh faktin se propozimi për plotësimin e rendit të ditës konsiderohet çështje e ngutshme, komisioni propozon amendament për plotësimin e rendit të ditës të datës 20 shtator 2018, me shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pra, do të thotë ka një propozim edhe për katër pika shtesë.

Për të futur në këtë seancë të jashtëzakonshme pika të rendit të ditës duhet mirëkuptimi i të gjithë deputetëve me mocion procedural.

Në qoftë se pajtoheni, nëse nuk ka reagim e fusim, në qoftë se ka mirëkuptim të këtyre deputetëve, kjo seanca është thirrur nga këta deputetë, po nuk ka, nuk futet. Avdullah Hoti, si propozues i seancës së jashtëzakonshme.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Ne kemi pasur dje mbledhjen e Kryesisë dhe jemi dakorduar në mbledhje aty që përveç tri pikave që ne i kemi kërkuar, si propozues të kësaj seance, të jetë edhe një pikë tjetër:

*- Shqyrtimi i Projektligjit për aderimin e Kosovës në Marrëveshjen për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike.*

Duke qenë se është seancë e jashtëzakonshme, ne nuk e shohim të arsyeshme që të shtohen edhe pika të tjera. Është seanca tjetër menjëherë pas kësaj, mund t'i shtoni në atë seancë të gjitha pikat që ju i shihni të arsyeshme, por ne kërkojmë që kjo seancë e jashtëzakonshme të zhvillohet me pika të rendit të ditës që i kemi kërkuar ne si propozues të seancës dhe me këtë pikën shtesë që jemi dakorduar dje në Kryesi. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë mund ta vë për mocion procedural, vendimmarrjen e merrni ju në seancë, unë nuk imponoj, as nuk fus asnjë pikë të rendit të ditës, në qoftë se ju nuk e votoni, do të thotë mocioni procedural është 2/3 e prezentëve çka votojnë.

Kjo është ajo, të mos e komplikojmë. A të shkojmë në votimi, futen këto katër pika të rendit të ditës apo nuk futen.

Memli Krasniqi, urdhëro, fjala për ju!

**MEMLI KRASNIQI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Sinqerisht çdo hap që po bëhet në këtë farë lojën e ulët me Kuvendin e Kosovës po e bën më të pakuptimtë krejt këtë situatë, të cilën veçanërisht Grupi Parlamentar i LDK-së është duke e stimuluar.

Sot jemi në seancë të jashtëzakonshme t'i votojmë disa pika, projektligje, të cilat janë në këtë Kuvend qe nja katër muaj.

Javën e kaluar kanë qenë këtu, këta nuk kanë ardhur e s'i kanë votuar. S'i kanë votuar as para këtij bojkotit të ri që e kanë filluar në sezonin e shtatorit.

Dje, pardje, ju ka rënë në mend që janë të rëndësishme këto pika, për çka kemi folur me muaj të tërë dhe unë po dua të di sot pse është më e rëndësishme programi 'Evropa për qytetarët' se sa 'Evropa kreative', janë dy programe të njëjta që trajtojnë fusha të ndryshme dhe pse duhet të refuzojë sot prapë LDK-ja përfshirjen, kur i ka kryer procedurat dhe është program, prej të cilit përfiton krejt skena kulturore artistike e vendit tonë, është vonuar për të njëjtat arsye, siç janë vonuar këto, dhe sot duhet të dalë kundër, është për mua e pakuptimtë dhe jo vetëm kjo, po nëse është thirrur kjo seancë me idenë që ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare e kemi shumë të rëndësishëm, atëherë faleminderit që keni ardhur ta kryeni punën tuaj për çka jeni zgjedhur prej popullit, po atëherë pasi veç keni ardhur sot, hajde po i shtimë krejt ato që janë për t'i ratifikuar, që janë për të mirën e qytetarëve, meqenëse po thirrreni në të mirën e qytetarëve edhe në letrën që keni kërkuar seancë të jashtëzakonshme dhe po i votojmë të gjitha.

Cila është arsyeja sot të thuhet po e votojmë IPA-n, po nuk po e votojmë 'Evropën', është i njëjti koncept, janë programe të Bashkimit Evropian, janë programe për qytetarët e Kosovës.

Po mendoj, ne jemi këtu sot duke pasur mirëkuptim, edhe duke e kuptuar politikën dhe duke i kuptua këto taktika të marrëdhënieve me publikun, krejt është në rregull, sepse më me rëndësi është benefiti që kanë qytetarët, po nëse benefit kanë qytetarët dhe prej 'Evropës kreative' që kryetari i komisionit e propozoi, e bëri një mocion procedural, unë nuk po mund ta kuptoj pse janë kundër, pse duhet qenë kundër të votohet 'Evropa kreative' nëse sot keni vendosur ta votoni 'Evropën për qytetarët' ose "ERASMUS +".

Për mua është sinqerisht shumë e pakuptimtë, po ashtu e ulët, sa i përket qëndrimit tonë, ne do ta votojmë.

**KRYETARI:** Faleminderit!

Është edhe rruga Kijevë-Zahaq po ashtu, në këtë marrëveshje ndërkombëtare, ta keni parasysh. Glauk Konjufca e ka fjalën.

**GLAUK KONJUFCA:** Po tash ne duhet t'i kthehemi prapë argumentit pse kemi ardhur deri këtu, nëse nuk e shqyrtojmë këtë çështje, nuk mund ta kuptojmë bojkotin e opozitës.

Për t'iu kthyer argumentit qendror, argumentit në thelb, është që pushteti ka dashur të na e japë një leksion, që është nënshtrimi i opozitës, të na tregojë që ju pa mazhorancë se nuk mund ta mbani asnjë seancë të Kuvendit të Kosovës. Kjo është mbyllje e gojës opozitës, thjesht, unë kështu e kam kuptuar.

E tash opozita po do juve t'ju edukojë në kuptimin politik, që përnjëmend, nëse e këqyr këtë Qeveri me numra, pa opozitën asgjë nuk bëhet, asgjë nuk mund të ecni pa opozitën përpara, duhet të mësoheni, duhet të edukoheni me këtë mësim elementar të demokracisë, pa opozitën nuk ka parlamentarizëm në këtë vend dhe ju po e refuzoni këtë punë.

Kështu që për këtë arsye unë mendoj që duhet t'i kthehemi debatit aty ku e ka vendin, e debati e ka vendin në argumentin që ju duhet lejuar mbajtjen e seancës së opozitës.

Pasi filluat me pyetjet pse, pse, pse po e votoni këtë, pse s'po e votoni këtë? E pse të gjitha këto qenkan më të rëndësishme se territori i Kosovës? Edhe se presidenti ynë, i cili ka dalë atje dhe e ka një projekt të vetin personal, do ta shtyjë deri në fund, pse të mos mbahet ajo seancë e opozitës që t'i vendoset një rezolutë, e cila e qartëson atë çka është sovraniteti i Kosovës, çka janë kufijtë e Kosovës, paprekshmëria e kufijve të Kosovës.

E nëse doni t'i jepni zgjidhjet bojkotit, zgjidhja është kjo: duhet të mbahet seanca e opozitës, të cilin ju e keni ndaluar, e keni rrëmbyer, kryeministri me idenë e tij të orës 9:00 të mëngjesit, dhe nëse zgjidhet kjo, atëherë mund të shpresohet që jeta parlamentare mund të zhvillohet. Nëse nuk zgjidhet kjo, atëherë natyrisht që opozita do ta diktojë ritmin e jetës parlamentare në Kosovës, deshët a s'deshët.

**KRYETARI:** Faleminderit! Ne jemi në seancë të jashtëzakonshme, tash po flas vetëm për procedura.

Grupet parlamentare le të përcaktohen a doni t'i vejmë në votim a jo? A do ta përkrahin këtë mocion procedural, në fund e vej në votim, futen, nuk futen, kjo është çështje juaja si deputetë, është shumë e qartë situata si mocion procedural. Nga kryetarët e grupeve parlamentare, kush dëshiron tjetër, jo deputetët, ju kisha lutur, se nuk jemi në debat, s'mund ta hap, se me dëshirë jua kisha dhënë fjalën, po s'po mundem.

Po shkojmë vetëm kështu. Bilall Sherifi, vetëm kryetarët e grupeve, në qoftë se dëshirojnë, shkojmë e votojmë, vendimmarrja është juaja, nuk po futem në debat politik fare.

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, kryetar!

Nuk do të futem në debat politik, pajtohem me ju, është një seancë e jashtëzakonshme, tash kemi në rend të ditës një mocion procedural.

Unë vetëm desha të shpreh në emër të Nismës mbështetjen që kjo çështje të futet në rend të ditës dhe të theksoj se unë u informova nga anëtarja jonë në komision, që e kemi deputeten Albulena Balaj-Halimaj, se edhe LDK-ja e ka mbështetur që të futet në rend të ditës në komision, anëtarja e LDK-së, nuk e ki a është e vërtetë a jo, po do të kisha pasur dëshirë të sqarohemi rreth kësaj dhe të ecim përpara dhe pastaj të kalojmë në seancën tjetër, ku i kemi 26 pika. Faleminderit!

**KRYETARI:** Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Teuta Haxhiu, në emër të Aleancës, vetëm qëndrimin e Grupit Parlamentar.

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, kryetar!

Po, ne e përkrahim propozimin e kryetarit të Komisionit për Arsim, zotit Kurteshi, ngase paraprakisht e kishim një mbledhje të komisionit, ku të gjitha subjektet politike pothuajse ishim unanim në komision që të vijë në Kuvend dhe kjo marrëveshje të ratifikohet karshi edhe marrëveshjeve të tjera që janë të propozuara për sot.

**KRYETARI:** Atëherë, ne po shkojmë në votim të mocionit procedural. Para se të hyj në votim, konsultim nuk ka nevojë, apo dëshironi kryetarët e grupeve parlamentare? Vetëm se po i rrezikojmë të gjitha.

Atëherë shkojmë, mocioni procedural është 2/3 e deputetëve prezentë, në qoftë se votojnë, ta kemi parasysh, atëherë futen pikat e rendit të ditës, katër pika të reja të rendit të ditës, të cilat i lexova, të mos i lexoj edhe një herë, tri i lexova unë, njëherë e lexoi edhe kryetari i Komisionit Parlamentar, zoti Ismajl Kurteshi.

Përgatitemi për votim, regjia, a mund të shkojmë në votim? Votojmë tash, për mocion procedural.

KRYETARI: 86 deputetë kanë votuar, 71 për, 15 kundër, asnjë abstenim, me dorë edhe dy, cila është vota juaj, zonja Mimosë? Për! Zoti Haxhi Shala? Për! 88 deputetë kanë votuar. 73 për, 2 me dorë, 71 në mënyrë elektronike dhe 15 kundër. Edhe një po? Për! 89 deputetë, 74 për, 15 kundër, zero abstenim.

Kuvendi vendosi që miratimi i katër projektligjeve të lartpërmendura të bëhet me procedurë të përshpejtuar, si dhe shqyrtimi i tyre të radhitet për seancën plenare si pika 1, 2, 3.

Shkojmë në votime, të nderuar deputetë!

### **1. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian**

Diskutimi për këtë pikë të rendit të ditës ka përfunduar. Do të thotë, shkojmë në votim, është marrëveshje ndërkombëtare, duhet të ketë 2/3 e deputetëve që votojnë. Pa qenë 80 deputetë, s'kalon, kjo për të qenë të qartë. Do të thotë, 80 për.

A jemi gati? Regjia dhe deputetët përgatiten për votim, 107 deputetë janë në sallë, është edhe një amendament tek Projektligji për IPA-në 2017, ta keni parasysh.

Në rend të parë shkojmë për amendament, shkojmë me dorë, në këtë projektligj është propozuar një amendament nga Komisioni Funkcional, për miratimin e tij kërkohen së paku 80 vota për. Unë pyes veç kush është kundër, 107 deputetë janë prezentë. Kush është kundër? Kundër, ju lutem! Abstenim a ka? 107 janë prezentë, kundër janë 9 deputetë, do të thotë i bie 98 deputetë janë për. Miratohet!

Shkojmë në votimin e Projektligjit nr. 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian në tërësi. Mendova se janë dy amendamente, nganjëherë unë edhe po i kaloj shpejt, s'ka faj Adem Mikullovcit, faleminderit, zoti Mikullovcit!

Përgatitemi për votim, votojmë tash projektligjin në tërësi.



101 deputetë kanë votuar. 93 për, 8 abstenime.

Kuvendi e miratoi Projektligjit nr. 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Faleminderit të gjithëve! Edhe tri me dorë, vota është për! Atëherë, shtohen edhe këto tri vota në konstatimin për kalim. Administrata e ka për obligim të evidencojë edhe cilët deputetë janë.

## **2. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-094 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin "Evropa për qytetarët"**

Edhe për këtë pikë të rendit të ditës debatet kanë përfunduar. Në këtë projektligj janë propozuar dy amendamente nga Komisioni FunkSIONAL, për votimin e tyre duhen po ashtu 80 vota për. A ka mundësi t'i vej të dyja përnjëherë, apo ka reagim? Në qoftë se ka reagim, lajmërohuni dikush. Amendamentet, të dyja përnjëherë, po urdhëro, zonja Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Vetëm një sqarim, Administrata është e njoftuar, por edhe deputetët që kanë qenë në mandatin e kaluar dhe kjo lidhet edhe me amendamentin që e miratuar paraprakisht, edhe këto tani. Në mandatin e kaluar kur vinin marrëveshjet me fusnotë, Kuvendi i Kosovës me 2/3 ka miratuar një dokument që quhet "Deklaratë", e cila thotë, nën një: "Kuvendi i Kosovës e njeh Kosovën vetëm në bazë të emrit të saj kushtetues si Republikë e Kosovës". Nën dy: "Në përputhje me nenin 18 të Kushtetutës, të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare ratifikohen me ligj që i referohet Kosovës sipas emrit të saj kushtetues", dhe nën tre: "Kjo deklaratë do t'i bashkëngjitet secilës marrëveshje ndërkombëtare, e cila ratifikohet në Kuvend nga sot e tutje".

Pra, nga sot e tutje, që nënkupton e ka obliguar Kuvendin, pra edhe për këtë mandat që kjo deklaratë të bashkëngjitet, e jo të shkohet me amendamente siç e bëmë me marrëveshjen paraprake apo këto, ku me amendamente të Komisionit FunkSIONAL ndryshohet referimi. E para, ministritë duhet të jenë tepër të kujdesshme që kur të sjellin tekste të projektligjeve, të mos i referohen Kosovës vetëm si Kosovë, por me emrin e saj kushtetues, pra Republikë e Kosovës. E dyta, mjafton që çdo marrëveshje ndërkombëtare, ku ka fusnotë apo Kosova nuk përmendet me emrin e saj kushtetues, t'i bashkëngjitet kjo deklaratë, e cila është miratuar me 2/3 dhe na ka obliguar që edhe këtyre marrëveshjeve që sot po u referohemi të bëhet pra pjesë e saj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Blerta Deliu-Kodra prej Komisionit për Integritet Evropian e ka kërkuar fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Vetëm sa për qartësim, janë dy amendamente, të cilat janë propozuar nga Komisioni për Integritet Evropian dhe janë votuar nga të gjithë anëtarët e Komisionit për Integritet me unanimitet, do të thotë në tekstin e Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin “Evropa për qytetarët”, në titullin e projektligjit para fjalës “Kosovës” të shtohet fjala “Republikës së Kosovës” dhe ky ndryshim do të thotë vlen për tërë tekstin e projektligjit.

Si dhe, amendamenti i dytë në tekstin e preambulës fjala “projektligjin” të zëvendësohet me fjalën “ligji” dhe teksti vazhdon si në projektligj. Do të thotë, janë amendamenti i parë dhe i dytë, të cilat janë votuar nga komisioni dhe për të cilat foli edhe zonja Osmani, dhe për të cilat natyrisht unë si kryetare e komisionit kërkoj që të marrin mbështetjen e seancës.

**KRYETARI:** Faleminderit! Ne i marrim parasysh krejt këto sqarime dhe kur e votojmë, e votojmë në vëmendjen tonë edhe ‘Deklaratën’. Do të thotë, futet, por një herë të shkojmë me amendamentet edhe ‘Deklarata’. Amendamentet janë, keni parasysh, secili prej jush i dinë edhe çka zonja Deliu-Kodra e tha. A shkojmë i votojmë të dyja përnjëherë? A ka reagim? Nuk ka!

Kush është kundër dy amendamenteve të propozuara? A ka abstenim?

107 deputetë janë prezentë në sallë. 9 janë kundër. Amendamentet miratohen me 98 deputetë për.

Tash e votojmë projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara edhe në vëmendjen tonë është edhe ‘Deklarata’, të cilën e ka bërë ky Kuvend. Atëherë, regjia dhe deputetët përgatiten për votim, votojmë tash!

103 deputetë, sa me dorë, më fal? 2 me dorë.

105 deputetë, 96 janë për dhe dy ngritjet me dorë janë për, 94 në mënyrë elektronike, dy kundër, 7 abstenime.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-094 për e ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin "Evropa për qytetarët".

### **3. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-095 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në "ERASMUS +", Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport**

Diskutimet kanë përfunduar. Të pranishëm në sallë janë 107 deputetë, regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

Sa vota janë me dorë? 2 vota janë me dorë, 97 deputetë për. Asnjë kundër, asnjë abstenim. Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-095 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në "ERASMUS +", Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport.

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-099 për aderimin e Kosovës në Marrëveshjen për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA)**

Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, në mbështetje të nenit 60, paragrafi 3, si dhe nenin 69 paragrafi 5 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar Projektligjin nr.06/L-099 për aderimin e Kosovës në Marrëveshjen për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA) dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Zoti ministër Mahir Jaghillar, të lutem, na e arsyeto projektligjin dhe paraqite.

MINISTRI MAHIR JAGXHILLAR: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Më lejoni t'ju prezantoj Projektligjin për aderimin e Republikës së Kosovës në Shkollën Rajonale të Administratës Publike (ReSPA).

Me aderimin Republika e Kosovës e avancon statusin e saj në arenën ndërkombëtare, duke qenë e pranishme në forumet rajonale dhe ndërkombëtare shumëpalëshe. Kjo organizatë është themeluar më 2 maj të vitit 2006, nga përfaqësuesit e Republikës së Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës, Republikës së Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Republikës së Serbisë. Arsyeja kryesore e hartimit të këtij projektligji është që Kosova përmes përfaqësuesve të saj të jetë pjesëmarrëse në aktivitete që ofron ReSPA për administratën publike, pra në analizën e nevojave rajonale, trajnimin e punonjësve të shërbimit publik, sistemet e trajnimit, rrjetet, shkëmbimet dhe komunitetet e praktikës, burimet e informacionit, metodologjitë dhe materialet e trajnimit.

Kostoja e aderimit të Republikës së Kosovës në organizatën ReSPA do të jetë 150 mijë euro në vit, kjo kosto është buxhetuar për vitin vijues dhe për vitin e ardhshëm. Gjithashtu, më lejoni të

ju informoj se dje në komisionin parlamentar jemi dakorduar që ligji të jetë më i saktë, të bëhet amendamenti i ligjit, i cili titulli ndryshon në “Projektligjin për aderimin e Kosovës në Shkollën Rajonale të Administratës Publike ReSPA”. Projektligji është bashkangjitur si dokumentet shtesë, edhe rezoluta e Bordit ReSPA të datës së 22 nëntor 2013, nga takimi i zhvilluar në Split të Kroacisë dhe e nënshkruar nga Ministria e Administratës Publike së Kroacisë, si kryetar i Bordit të atëhershëm për pranimin e Kosovës në këtë shkollë rajonale.

Të nderuar deputetë,

Në këtë aspekt ju propozoj që ta aprovoni këtë projektligj që të krijojmë mundësi edhe të jemi anëtarë të barabartë në shkollën rajonale, ku jemi tashmë si anëtar vëzhgues. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, zoti ministër! Nait Hasani në emër të Komisionit Funkcional, ju lutem, fjala është për ju.

**NAIT HASANI:** Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për kryeministrin,

Ministrat,

Kolegët deputetë,

Komisioni dje ka mbajtur mbledhje dhe e ka shqyrtuar këtë projektligj, i ka rekomanduar dhe i rekomandon seancës plenare ta miratojë. Është mjaft i rëndësishëm, por kemi nxjerrë dy amendamente, për të cilët kemi kërkuar që të trajtohen dhe të shqyrtohen. Ne kemi kërkuar që amendamenti i parë të lihet në titullin e projektligjit “Projektligji për aderimin e Kosovës në Shkollën Rajonale të Administratës Publike ReSPA” dhe amendamenti dy është riformulim, qëllimi i këtij ligji është aderimi i Kosovës në Shkollën Rajonale të Administratës Publike ReSPA.

Kërkojmë nga kolegët deputetë që ta miratojnë, është i rëndësishëm. Ndërsa ato që i përmendi edhe ministri, unë mendoj se kjo shkollë është filluar për t’u realizuar më 2 maj 2006, atëherë kur ka qenë Administrata e UNMIK-ut në Kosovë dhe prej atëherë është bartur, dhe tani kjo nuk ka mundësi të ndryshohet në pjesën e fundit, por është çështja se ne e kemi dhe atë marrëveshjen që e përmendi dhe Vjosa që duhet t’i shtohet kësaj marrëveshjeje dhe kjo të jetë e plotë si Kosovë, prandaj Kosova aderon në marrëveshjen për ReSPA. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Në emër të grupit parlamentar, cili është? Armend Zemaj, urdhëro!

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit, kryetar!

E para më lejoni kolegë deputetë që së pari ta japim arsyetimin sa i përket kësaj marrëveshjeje, por të theksojmë se siç duket duke marrë për bazë problemet që ka koalicioni qeverisës edhe në aspektin ta quajmë kështu gjuajtjes së fjalëve, të treguesit të të fortit brenda koalicionit, PDK-ja përpiket që ta vërë para sprove në seancë plenare Lidhjen Demokratike të Kosovës për ta futur në

një lloj inati nëse duhet t'i votojë marrëveshjet që janë në interes të përgjithshëm të qytetarëve të vendit.

Ne e kuptojmë edhe këtë gjuhë, sepse edhe marrëveshjet që kanë përfitime financiare i shihni në interesa të ngushta të përfitimit. Kjo nuk është as mënyra e të vepruarit tonë, por saktësimi i procedurave dhe vendimmarrjes brenda Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke e respektuar Rregulloren dhe Kushtetutën tonë, së cilës i nënshtrohemi.

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar këtë marrëveshje dhe nëpërmjet anëtarëve tanë në Komisionin Funkcional, interesimi ynë që të marrim pjesë në mekanizma, qofshin ata rajonalë apo edhe ndërkombëtarë është i gatshëm, por ministri duhet të na sqarojë si nënshkruer i kësaj marrëveshjeje në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës se kush është nënshkruer në këtë fazë? Kjo, pasi vendimin për të marrë pjesë e kanë marrë në kohën e UNMIK-ut, ndërsa sot po flasim pas pesë vjetësh, edhe nga ai vendimi i Bordit të datës 22 nëntor 2013.

Ju duhet ta siguronit Kuvendin e Kosovës, pavarësisht asaj se edhe arsyetimi është në bazë të fusnotës që e tejkalon edhe votimin paraprak për të cilin votuam dy herë me radhë, por ju duhet ta siguronit që këtë marrëveshje ju do ta nënshkruani si Republika e Kosovës dhe si Qeveria e Republikës së Kosovës, për të na mundësuar edhe neve votimin e drejtë dhe vendimmarrjen sa i përket anëtarësisë dhe marrjes pjesë në Shkollën Rajonale për Administratë Publike. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Memli Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, e ka fjalën.

**MEMLI KRASNIQI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Çështja e votimit për Marrëveshjen ReSPA ka qenë disa herë çështje diskutimi edhe më herët dhe mendoj se ministri Jagxhilar ka bërë mirë që e ka sjellë edhe rezolutën e Bordit qeverisës të ReSPA-s me numër 03/2013, ku qartësohet se Bordi qeverisës nëpërmjet kësaj rezolute në mënyrë unanime ka marrë vendim apo e ka adoptuar, e ka aprovuar një rezolutë sipas së cilës Kosova bëhet anëtar i ri i ReSPA-s.

S'kemi nevojë të bëjmë politikë. Kosova në ReSPA është me fusnotë dhe marrëveshjet që sapo i kaluam janë marrëveshje që Kosova i ka nënshkruar me fusnotë, kështu që nuk mund të jetë kjo punë ose-ose, por është edhe-edhe. Tri marrëveshjet e kaluara, të gjitha i kemi votuar. Në ato marrëveshje Kosova në Bashkimin Evropian është me fusnotë, siç e ka pranuar ky Kuvend atë marrëveshje më 2013 edhe për këtë çështje. Kështu që edhe ReSPA është me fusnotë. Nuk mundet, unë besoj, asnjëri këtu të garantojë që në këtë periudhë, në këtë fazë, ka për ta ndërruar dezinimin e Kosovës. Nëse i votuam edhe marrëveshjet e tjera, të cilat kaluan para pak minutash, atëherë unë besoj se pas këtij sqarimi tepër të rëndësishme për shkak të asaj fazës së

UNMIK-ut që u përmend dhe që është diskutuar edhe më herët, unë besoj se ne duhet ta mbështetim, në mënyrë që t'i krijojmë hapësirë edhe Kosovës t'i shfrytëzojë ato mundësi që i krijon kjo shkollë rajonale e Administratës Publike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi vetëm edhe një. Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar. Ju lutem, nëse e kërkojnë grupet parlamentare, kërkojeni fjalën në mënyrë elektronike.

GLAUK KONJUFCA: Duket fare qartë se Qeveria e Kosovës nuk ka bërë asnjë përpjekje serioze për ta shqyrtuar dhe për ta zgjidhur këtë çështjen e reprezentimit nëpërmjet UNMIK-ut atje. Ne mendojmë se nuk është e parëndësishme. D.m.th., nuk mund të thuash me rëndësi pjesëmarrja nëpër këto organizata, pavarësisht çka figuron atje si nënshkruar në emër të Kosovës.

Unë mendoj se pas pavarësisë së Kosovës, në vitin 2008, krejt këto probleme që kanë qenë të përfaqësuara nga UNMIK-u, tash duhet t'i marrë përsipër Kosova. Kjo nuk është bërë nga Qeveria jonë dhe atje në plot dokumente të kësaj shkolle figuron që Kosova përfaqësohet nëpërmjet UNMIK-ut dhe Rezolutës 1244. Pa e zgjidhur këtë, unë mendoj se është e dëmshme të vazhdohet kështu dhe Vetëvendosja nuk e voton këtë marrëveshje.

KRYETARI: Ka vetëm një deputete të lajmëruar. Grup parlamentar, nuk ka të lajmëruar. Vjosa Osmani-Sadriu.

VJOSA OSMANI-SADRIU: Faleminderit!

Në radhë të parë më duhet ta ripërsëris vërejtjen. Zoti kryeministër, besoj shumë se nga tash e tutje në mbledhje të Qeverisë do të kërkonin nga ministrat tuaj që për ligjet që i hartojnë dhe propozojnë për miratim në Kuvend ta njohin emrin kushtetues të Republikës së Kosovës dhe jo të vijnë me tekste të ligjeve që i referohen Kosovës me emër, që s'është emër i saj kushtetues, e para.

E dyta, për ministrin Jagxhilar, a mund ta sqaroni një gjë? Në Deklaratën e Pavarësisë në vitin 2008, Kosova ndër të tjera ka miratuar parimin e suksedit apo trashëgimisë së traktateve të marrëveshjeve ndërkombëtare, ku thuhet se Kosova e merr përsipër t'i trashëgojë edhe automatikisht të vazhdojë t'i implementojë të gjitha marrëveshjet që kanë qenë të nënshkruara nga ish-Jugosllavia – RSFJ, dhe nga UNMIK-u, në emër të Kosovës.

Tash, në qoftë se, është mirë të të dëgjojmë, sepse nuk je duke na dhënë asnjë sqarim të saktë, ju jeni duke e respektuar atë pjesë të Deklaratës së Pavarësisë, thjesht duhet që marrëveshjen që ka qenë atëherë e nënshkruar të vazhdojë ta zbatojë në praktikë, por si duket ju e keni filluar procesin nga fillimi, duke e rinegociuar këtë marrëveshje ndërkombëtare. Në qoftë se e keni

rinegociuar, pyetja është pse s'keni filluar ta rinegocioni nga fillimi, ku Kosova përfaqësohet nga UNMIK-u dhe s'keni kërkuar... po ky është teksti që na e keni sjellë, sepse po shoh që po na e bëni me kokë "jo". Teksti që na ka ardhur neve është ky: Misioni i Kombeve të Bashkuara në emër të Kosovës dhe në fund nënshkrimi është Misioni i Kombeve të Bashkuara në emër të Kosovës.

Pastaj në vitin 2013, e kemi vendimin e Bordit të ReSPA-s, ku thuhet që Kosova njihet tash me fusnotë. Nëse është ashtu, pse nuk ka asnjë dokument brenda tekstit që ju e keni sjellë si Qeveri që e reflekton, nën një, këtë ndryshim të vitit 2013 të Bordit të ReSPA-s, dhe po ashtu faktin se ju si Qeveri e Kosovës e njihni Kosovën vetëm me emrin e saj kushtetues.

Pra, po pajtohemi që si duket Qeveria gjatë negociatave që i ka bërë me Bordin e ReSPA-s nuk e ka bërë as përpjekjen më të vogël as për t'i njohur parimet e të drejtës ndërkombëtare të njohura edhe në Deklaratën e Pavarësisë, siç është parimi i suksedimit, por edhe kur e ka filluar nga zeroja këtë proces të hyrjes në këtë marrëveshje ndërkombëtare, nuk ka tentuar të ndryshojë asgjë. Në qoftë se e fillon nga zeroja procesin, duhet të ndryshosh diçka, por në veçanti emri me të cilin përfaqësohet Republika e Kosovës.

E fundit, sa u përket deklaratave paraprake, një sqarim: Marrëveshja për fusnotë asnjëherë nuk është ratifikuar në Kuvendin e Kosovës. Ka qenë marrëveshje e konsideruar teknike, e nënshkruar nga Edita Tahiri, dhe në atë kohë LDK-ja ka dalë kundër asaj marrëveshjeje.

**KRYETARI:** Ministër! Ndërkohë, ju kisha lutur për vëmendje. Kishim shkuar në votim, pas këtij sqarimi. Situata është kjo që është në të gjitha qeveritë, nuk ndërron statusi i Kosovës, është shtet i pavarur e sovran. Urdhëro ministër, fjala për ju!

**MINISTRI MAHIR JAGXHILAR:** Vërtet kam nevojë të sqaroj, sepse nuk ka qenë qëllimi që të silllet një marrëveshje, e cila kthen në një situatë krejt tjetër.

Situata ka filluar në vitin 2006, kur UNMIK-u ka qenë pjesë e krijimit të shkollës. Ndërkohë, vitin 2008 ka ndodhur pavarësia e Kosovës dhe UNMIK-u nuk ka nënshkruar, UNMIK-u është tërhequr dhe më pastaj kurrfarë lidhje me këtë shkollë nuk ka pasur.

Në vitin 2012, Qeveria e Republikës së Kosovës pas marrëveshjeve edhe të Brukselit nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, ka kërkuar të jemi anëtar i plotë në ReSPA-s. Bordi i ReSPA-s, i cili ka qenë shteti i Kroacisë, Republika e Shqipërisë, Republika e Malit të Zi, Republika e Serbisë, Bosnjë-Hercegovina, unanimisht kanë pranuar që në përputhje me marrëveshjet e Brukselit, faktikisht edhe me fusnotën, Kosova të jetë pjesë e shkollës rajonale, ku jemi tash si anëtar vëzhgues, edhe në organizata të tjera, si CEFTA e të tjera, të cilat janë të konfirmuara.

Në këtë aspekt, në qoftë se dëshirojmë të jemi pjesë në këtë shkollën rajonale, ku donator kryesor është Bashkimi Evropian dhe e përkrah, por për të cilën deri tash ne kemi marrë pjesë si vëzhgues, dhe shumë zyrtarë të institucioneve të ndryshme, shërbyesit civilë kanë shkuar në trajnime, atëherë duhet të jemi anëtar të rregullt dhe ta paguajmë anëtarësimin.

Në këtë rast, nuk ka asnjë lidhje me UNMIK-un. UNMIK-u as nuk ka nënshkruar. UNMIK-u vetëm ka qenë në ato takime fillestare, në vitin 2006. Pas pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, UNMIK-u në këtë shkollë asnjë lidhje nuk ka, asnjë drejtim nuk bëhet as për mua si ministër, as për kryeministrin, as për zyrtarët. Gjithmonë ftesa vjen me fusnotë. Është sipas marrëveshjeve, fatkeqësisht. Unë atë nuk mund ta ndryshoj, por UNMIK-u askund nuk përmendet, është një keqkuptim.

**KRYETARI:** Po kryeministër, keni të drejtë çdo herë. Kryeministri i Republikës së Kosovës, urdhëro!

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:** E para, ne kemi vendim si Qeveri, nuk përfaqësojmë çfarëdo organizate apo mekanizmi, qoftë rajonal, qoftë më gjerë, nëse Kosova është e ftuar, ose është pjesë si UNMIK.

Në fakt, e kemi pasur problemin me disa prej tyre. Nuk është i autorizuar asnjë ministër, qoftë z. Jagxhilar, qoftë cilido tjetër, as Qeverisë, as Parlamentit, t'i sjellë dokumente ku Kosova identifikohet si UNMIK. Pra, nuk e ka këtë autorizim.

Ajo që ministri me gjasë provoi t'jua shpjegojë është se në themelim të kësaj shkolle, ose kësaj iniciative rajonale, që është financuar nga BE-ja si themeluese, nuk kemi qenë si Qeveri apo si Kosovë, por si UNMIK, me pavarësimin e Kosovës atë të drejtë e kemi ne. UNMIK-u nuk është më nënshkrues i vazhdimësisë, ka qenë në nisje, por nuk është më në vazhdimësi.

Nëse kjo mjafton për ju, ju siguroj se si Kosovë, pra si Qeveri nuk ju biem në lajthitje, që ju të votoni dokumente ku Kosova identifikohet si UNMIK. Nuk e kam as unë këtë të drejtë, as këtë autorizim, as me Kushtetutë, as me marrëveshjen e mëvonshme për fusnotë, e cila po ashtu nuk më pëlqen, por është realiteti ynë për përfaqësim në këto iniciativat rajonale, e ku e di unë. Pra, i kisha lutur deputetët, nëse ju mjafton kjo, ju lutem ta merrni shansin ta votojmë edhe këtë ligj të paraqitur. Faleminderit!

**KRYETARI:** A dëshironi replikë? Replikë keni të drejtë, diskutimin e keni mbaruar. Janë edhe dy deputetë, i treti je ti. Janë Milaim Zeka, Memli Krasniqi, pastaj jeni ju. Urdhëro replikë Vjosa Osmani, përgatitet Milaim Zeka pas replikës.



VJOSA OSMANI-SADRIU: Atëherë, zoti ministër edhe unë i përmenda të gjitha këto dokumente që i përmendët ju që janë miratuar pas vitit 2006, pra pas pavarësisë së Kosovës, duke e përfshirë vendimin e Bordit të vitit 2013.

Problemi është ky, asnjëra nga këto dokumente që e kanë ndryshuar statusin nga UNMIK në Kosovë me fusnotë nuk janë pjesë e marrëveshjes që ne sot ratifikojmë. Ne sot e ratifikojmë vetëm UNMIK-un, asgjë tjetër. Çka është dashur ju të bëni është bashkë me aktin e themelimit të kësaj organizate të vitit 2006 t'ia bashkëngjitni si ankese të marrëveshjes çdo dokument tjetër, ku statusi i përfaqësimit të Kosovës, apo mënyra si kjo organizatë e njeh Kosovën ka ndryshuar. Dhe, ne sot do ta ratifikonim çdo dokument tjetër, pra përfshirë edhe këtë të 2013-tës. E jo të ratifikojmë vetëm përfaqësimin e Kosovës si UNMIK në këtë organizatë, ky është problemi.

Nën 1, duhet t'i bashkëngjiten këto dokumentet e vitit 2013, nën 2 duhet të bashkëngjitet Deklarata e Kuvendit të Kosovës që e lexova më herët, që Kuvendi e njeh Kosovën vetëm sipas emrit të saj kushtetues, dhe pastaj bashkë me ato dy anekse të sillen për ratifikim në Kuvend. Kjo është!

KRYETARI: Po e shoh ministrin, prapë reagim, para se të futemi në debat. Urdhëro, ministër!

MINISTRI MAHIR JAGXHILLAR: Pikërisht me aprovimin e projektligjit, sepse ka një kosto buxhetore dhe duhet të bëhet ratifikimi. Ne vetëm do të aderojmë në atë shkollë, do ta realizojmë pagesën dhe do ta deponojmë në Qeverinë e Malit të Zi, sepse është selia në Danilovgrad, kërkesën për anëtarësimin, dhe nuk do të ndodhë asnjë nënshkrim, sepse ajo marrëveshje vetëm prolongohet.

Në çdo pesë vjet, në njëfarë mënyre ajo marrëveshje ku janë kriteret e funksionimit të shkollës vazhdohet të krijon rregulla sa u përket aktiviteteve të shkollës. Edhe në këtë aspekt, me aprovimin e kësaj nuk do të ndodhë nënshkrimi i marrëveshjes, do të jetë vetëm depozitimi i kërkesës dhe pranimit në atë shkollë. Këto janë rregullat. Unë dëshiroj t'ju informoj, me këtë akt, në qoftë se aprovohet, do të jemi pjesë e shkollës rajonale. Në qoftë se nuk aprovohet, atëherë më nuk do të jemi në gjendje të jemi pjesë e asaj shkolle dhe ky do të jetë përfundimi. Në ligj, nuk përmendet UNMIK-u, kryeministër!

KRYETARI: Ministër, a ka mundësi edhe një ndërhyrje, më fal, në plotësimin e kësaj. A ka mundësi, në qoftë se ka vullnet, rezoluta e ReSPA-s të Bordit administrues të ReSPA-s të vitit 2013 të futet në aneks. Po, po! Edhe deklarata e Kuvendit, në qoftë se mund ta gjejmë si modus të mesit, i futim të dyja, janë dokumente. Tash vetëm ta përfundojnë deputetët, Milaim Zeka, bëhet gati Memli Krasniqi dhe në fund Driton Selmanaj.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Në radhë të parë, ministri e ka të pamundur të bëjë sqarime kur ne si deputetë dëshirojmë ta dëgjojmë vetëm veten tonë, nën një, dhe, nën dy, të mendojmë gjithmonë te poenët politikë dhe të mendojmë te votuesit. Besoj që ata të cilët e diskutuan këtu para meje, e dinë më së miri se për çfarë marrëveshje është duke u bërë fjalë.

Shpeshherë ballkanasit kapen rreth shkumës, në vend që të kapemi rreth materies se çfarë ka në gotë. Sot, po diskutojmë rreth shkumës, e nuk po diskutojmë rreth rëndësisë të anëtarësimi të Kosovës në një shkollë rajonale. Le të çohet një deputet këtu dhe le të na tregojë se cili është dëmi i Kosovës në qoftë se ne anëtarësohemi në këtë shkollë. Jo fusnota, jo çfusnota, jo kjo, jo ajo! Këto janë krejt marrëzira dhe janë llafe të zhampareve të deficit që të na dëgjojë dikush atje nëpërmjet televizionit edhe të na vendosë në peshore se kush jemi më patriotë; unë apo ai, apo ajo.

Prandaj, dëshiroj të them një diçka: Po ta kishin prindërit tonë logjikën e një debati të tillë në kohën e Titos, kur ata kanë qenë kundër Jugosllavisë dhe kundër sistemit të Titos, asnjëri prej tyre nuk do të futej në një klasë mësimi ku varur ka qenë fotografia e Titos. Prandaj, në qoftë se ne vazhdojmë të diskutojmë në këtë mënyrë dhe të mos diskutojmë për rëndësinë e anëtarësimi në këtë shkollë rajonale të Republikës së Kosovës, atëherë i bëjmë dëm Kosovës dhe ne do të vazhdojmë këtu të bëjmë gara se kush jemi më patriotë. Është bërë edhe futbollit, ka hyrë si mesele e patriotizmit. Atje një kontratë për futboll, janë zgjuar pikërisht ata që e kanë lejuar Radiotelevizionin e Serbisë dhe është i lejuar dhe nuk ke se si ta ndalosh Radiotelevizionin serb në Kosovë, shesin patriotizëm edhe nëpërmjet një kontrate të futbollit.

Ose-ose, unë e kam dëgjuar një koleg timin, për të cilin kam shumë respekt, që thotë që mua me pengon transmetimi i ndeshjeve të futbollit në gjuhën serbe. Po atëherë, në qoftë se ne jemi aq patriotë, hajde i marrim këta deputetët e Listës serbe dhe ua ndalojmë fjalën dhe i nxjerrim prej sallës së Kuvendit, edhe i rrahim e shesim patriotizëm.

Mosni more, se kjo farë logjike neve vetëm na fundosë, vetëm na mbyl midis bunarit! Hajde votojmë, sepse është marrëveshje e rëndësishme për njerëzit tanë, për Kosovën. Dhe, kaq! Tani për patriotizëm ndoshta po e ndezim një luftë edhe njëherë me Serbinë edhe e shikojmë pastaj kur të ndezët lufta kush e vesh uniformën dhe kush se gjen ndonjë “shfajcaparati” për të ikur nëpër male. Prandaj, i ftoj deputetët me qëndrimin individual dhe qëndrimin që e kemi pasur në komision ta votojmë këtë marrëveshje, pasi është shumë e rëndësishme për Kosovën. Kaq, kryetar! Faleminderit!

KRYETARI: Zotëri Zeka, jo luftë, por paqe. Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Kryetar nuk po e zgjas hiç, kaloja fjalën kush është në radhë dhe shkojmë në votim, se pata të flasë pak për suksesionin, por po e lë se hyjmë në debat të rëndë pastaj.

KRYETARI: Faleminderit! Driton Selmanaj, edhe Glauku e ka kërkuar fjalën.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

Në fakt, edhe zoti Zeka, po edhe të tjerët, të cilët po mendojnë që Kosova në 2018-tën të mos u kushtojë rëndësi dokumenteve dhe t'i miratojë, ku nënshkruet për Kosovën është UNMIK-u akoma, unë po besoj që jemi gabim bazik, sepse ne po e dimë kush po thirret për Kosovën në Rezolutën 1244. Prandaj, ta harrojmë këtë së paku ne të cilët i kemi ndryshuar edhe rrethanat politike, edhe kushtetuese në Kosovë.

Çka po dua të them unë, vetëm deklaratat publike të ministrit dhe të kryeministrit: Reflektoni në dokumentet që na i keni sjellë, sepse diçka tjetër po thuhet, e diçka tjetër na ka ardhur. Për shembull, vetëm po e marr nenin e fundit të marrëveshjes, ku thotë: “Në dëshmitë e të nënshkruarit rregullisht të autorizuar për këtë qëllim, e nënshkruaj këtë marrëveshje”, edhe renditen; për Republikën e Shqipërisë, për Republikën e Bosnjës, për Republikën e Kroacisë, për Republikën e Maqedonisë, për Republikën e Malit të Zi, për Republikën e Serbisë dhe, në fund thotë, për misionin e Kombeve të Bashkuara që vepron në emër të Kosovës, në bazë të Rezolutës 1244.

Tash edhe si nënshkruet ne duhet në bazë të UNMIK-ut, ta heqim këtë, ta qesim në emër të Republikës së Kosovës, tani mund të pajtohemi ne që fusnota për shkak që për organizatat rajonale e kemi atë marrëveshje, dhe i bashkohet edhe deklarata të cilën e tha zonja Osmani, por edhe Rezoluta e Bordit të ReSPA-s, e cila e njih tash e tutje Kosovën si anëtare, ose me fusnotë, jo më UNMIK-un si palë negociuese. Kaq!

Reflektoni ato çka po i thoni në dokumente, ecim tutje. Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca. Ministër në fund, po jua jap fjalën në fund.

GLAUK KONJUFCA: Para disa minutave një ekspert i shkumës na tregoi se kjo puna e shtetit nuk ka lidhje qysh përfaqësohesh. Ai mund të jetë ekspert i shkumës, po për shtetin nuk po marrka vesh hiç. Ajo është çështje shumë precize dhe çështje fundamentale e shtetit është qysh përfaqësohet, jo a merr pjesë ai. Sa për të marrë pjesë, Serbia do të kishte dhënë miliarda euro, vetëm vendose aty “Serbia”.

Këtu ka pasur përpjekje shekullore që kjo punë të ndryshohet se përndryshe nuk do të kishte lidhje as sakrificë, as e gjithë përpjekja që e kanë bërë shqiptarët deri tani për liri e çlirim. Nuk mund t'i thuash, “shko përvoje me shtetet e tjera, me Slloveninë apo Maqedoninë çështjen e

përfaqësimit. Hajt ta qesim një fusnotë”. Hajt relativizoje shtetësinë tënde, të tregojnë ata çka mendojnë. A është e rëndësishme apo nuk është e rëndësishme, a më e rëndësishme pjesëmarrja, apo është më e rëndësishme sesi merr pjesë. Sesi merr pjesë është çështje esenciale për shtetin, e jo çka përfitoj unë. A po përfitoj disa bursa, a po përfitoj disa pjesëmarrje atje në atë shkollë. Ti në emër të pjesëmarrjes po e godet shtetin tënd në kurriz dhe po ia thyen kurrizin. Atëherë çfarë kuptimi ka kjo? Nuk ka kuptim as pavarësia, as pse e kemi shpallur, nuk ka kuptim shtetësia pastaj. Prandaj, lërin këto budallallëqe, nëse i biem shkurt e trup, kjo është çështje esenciale për shtetin; mënyra sesi përfaqësohet.

Nëse të dëgjon Serbia kështu, menjëherë të jep bursa sa të duash, vetëm ndërroja emrin Kosovës!

**KRYETARI:** Faleminderit! Mialim, emrin nuk ta ka përmendur. Replikë me Driton Selmanaj, atëherë.

**MILAIM ZEKA:** Edhe me Dritonin, edhe shkuma deshi t’i përgjigjet sapunit, që ma përmendi emrin, dhe ai iu referua fjalimit tim. Unë desha t’i them sapunit se ju nuk keni të drejtë fare të flisni për shtetin, ngase ti nuk e pranon shtetin e Kosovës, nën një. Ti nuk e pranon flamurin e Kosovës, nën dy. Ti nuk e pranon himnin e Kosovës, nën tre. Dhe, mbi bazën e kësaj, patriotizmi dhe angazhimi ynë kombëtar është treguar deri më 12 qershor ‘99.

Të gjithë këtu në sallë e njohim njëri-tjetrin dhe se do të ndryshonte diçka në Kosovës, siç m’u referua Driton Selmanaj, për njerëz si Dritoni edhe 100 vjet ne do të flisnim serbisht në sallë! Unë jam duke folur jo për shtet, por për shkollë. Në qoftë se ju mendoni që shkolla është në dëm të Kosovës, urdhëroni argumentojeni. E nëse hyjmë ne te fusnotat e si na detyron bashkësia ndërkombëtare që ne të ne nënshkruajmë e të mos nënshkruajmë, e të marrin pjesë ekipet sportive nëpër garat e ndryshme ndërkombëtare duhet të debatojmë edhe një muaj. Prandaj, e lëmë këtë, gjithkush e ka mendim e vet individual, gjithkush e ka bagazhin e vet patriotik etj., dhe nuk kemi nevojë këtu ta matim njëri-tjetrin në peshore. Kështu që pa fyerje, jepeni mendimin tuaj, por pa fyerje, dikush është shkumë, dikush është sapun, por të gjithë e kemi peshën tonë.

**KRYETARI:** Kryeministri ndërkohë e ka kërkuar fjalën.

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:** Nuk është problem! Shikoni është sot njëra prej ditëve me peshë të Parlamentit tonë, kur opozita ka rënë dakord, e ka thirrur një seancë për ta kryer një obligim që është nacional, në këtë rast. Janë marrëveshje që ndërlidhen me IPA, me BE, me integrimet tona, me perspektivën tonë.

Nuk po i kuptoj disa deputetë, sidomos të pozitës, kursejuni ju lutem! Keni plot raste ku mund t’i tregoni këto vlerësimet reciproke. Sot është momenti, nëse ka pengesë reale të mos votohet nuk

po votojmë, nëse ka bazë që ta votojmë, po e votojmë, po e kryejmë atë mision për të cilin jeni mbledhur, për të cilin e keni ftuar seancën. Edhe unë mendoj atë që e tha edhe ministri, edhe unë po ju them, është e patolerueshme që në dokumente të Republikës së Kosovës në vitin 2018 të figurojë ende përfaqësimi ynë, misioni i OKB-së. Ministri, në një mënyrë ose në një tjetër, jua shpjegoi ose ju kërkoi falje që nuk supozuar, ose nuk është menduar që është vazhdimësi, por vetëm në dokumentet bazë të origjinës, atëherë kur është nisur.

Nëse dëshironi ta përforconi këtë, qoftë me një dokument të caktuar, pra tip rezolute ose deklaratë të ministrit, ju lutem veproni. Ju kisha lutur, do të keni gjithë kohën për këto ngucjet mes vete, shfrytëzoni këtë seancë të cilin e keni ftuar për ta përfunduar këtë detyrë, për të cilin jeni bashkuar, ju lutem.

**KRYETARI:** Faleminderit! Driton Selmanaj, po e shoh replikë dëshiron. Të shkojmë, ministër a dëshiron...Urdhëro, zoti Selmanaj!

**DRITON SELMANAJ:** Pak kundër-replikë. Unë vetëm po i them të nderuarit që po të ishin njerëzit si Driton Selmanaj është e vërtetë që Kosova nuk do të ishte kështu, por do të ishte shumë më mirë. Po, për fatin e keq, janë shumë njerëz si ai që kanë dhjetëra aktakuza për mashtrime e dallavere, e si të tillë e kemi Kosovën kështu. E shokët dhe ai që kanë punë me aktakuza e me gjykata, vërtet e kanë sjellë Kosovën në këtë gjendje. Të ishin si Dritoni ishte harruar kjo punë dhe për shtetësinë e Kosovë, ndoshta do të flisnim tani për procese krejtësisht të tjera integruese, ndoshta edhe pjesë e BE-së, por për fatin e keq shumica janë si ai.

**KRYETARI:** Kundër-replikë, Milaim. Nuk ke të drejtë, Milaim, më vejnë keq! Arben, kërkoi falje, po të mundja unë këto replikat s'i kisha lënë fare, as kundër-replikat. Arben, a është në rregull?

**ARBEN GASHI:** Faleminderit, kryetar!

Po bëjmë debat kot, çështja është shumë e thjeshtë, ligjit i shtohet një nen, ku thuhet: "Pjesë e këtij ligji janë: Rezoluta e Bordit drejtues të ReSPA-s dhe vendimi i Kuvendit, i cili rekomandon që Kosovës t'i drejtohem me gjuhën e vet kushtetuese dhe juridike". Edhe kaq. Çështja tash është a po pranohet si amendament që propozohet në seancë, apo duhet dërguar në komision për ta bërë këtë amendament. Nëse pajtohet seanca që e bëjmë si amendament në seancë, vazhdojmë tutje, nuk kemi çka ta diskutojmë këtë Punë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, zoti Gashi!

Ne do shkojmë pikërisht ashtu. I kemi paraprakisht dy amendamente, pastaj kur të propozohet projektligji në tërësi do ta vë në votim me aneksin e 'Deklaratës' së Kuvendit dhe me aneksin 'Rezoluta e Bordit administrues të ReSPA'-së, të keni parasysh.

Atëherë, janë 92 deputetë, shkojmë drejt në votim.

Dy amendamentet e para shkojnë në votim, duhen 80 vota. A është dikush kundër nga 92. A ka kundër, ju lutem? 95 deputetë janë, edhe tre u futën në sallë, ndërkohë 95. A ka kundër dikush? A ka abstenim? Nuk ka, me 95 vota kalojnë dy amendamentet.

Tani jemi në votimin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara dhe me aneks 'Deklaratën' e Kuvendit dhe me 'Rezolutën e Bordit administrues të ReSPA'-së.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash! Faleminderit!

Situata është e qartë tani, edhe tre deputetë. Megjithatë janë 77, nuk janë 80. Do të futem edhe një herë në votim.

Në qoftë se ka mundësi, kolegë deputetë, zoti Pacolli është duke i thirrur kolegët në pjesën mbrapa në bufe, për arsye se nuk po dëgjohet zilha atje. Presim një minutë.

I kisha ftuar edhe publikisht, në qoftë se shohin transmetimin, le të kthehen në sallë për arsye se ishim 107 deputetë.

97 deputetë janë në sallë.

Ju lutem, kolegë deputetë,

Është e thjeshtë, tre butona janë, njërin prej tyre e shtypni.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara dhe me aneksin e 'Deklaratës' së Kuvendit e me 'Rezolutën e Bordit', votojmë tash:

Faleminderit!

Zonja Mimoza, edhe vota e juaj është 82, dy vota janë për me dorë, 80 në mënyrë elektronike, 82 deputetë kanë votuar, 78 për, zero kundër dhe 4 abstenime, Kuvendi e miratoi ligjin...

*(Reagime nga salla)*

...entuziazmi më ka përfshirë, kërkoj falje, por jo.

97 deputetë janë në sallë, a e votojmë edhe një herë?

Ju kisha lutur, ziles, kolegë deputetë! A votojmë me dorë në mirëkuptim? A ka dikush kundër të votojmë me dorë? Atëherë, a të votojmë me dorë këtë projektligj? E kam një përshtypje, nganjëherë nuk po punon mirë.

Hajde të shkojmë me dorë, nuk ka asnjë reagim kundër.

Votojmë tekstin e projektligjit, votojmë me dorë, 95 deputetë janë në sallë.

Kush është kundër? A ka abstenim? Jo, s'jam abstenim, unë kam rënë prej patriotizmit të ligës, për jam. Për kush është? Të gjithë të tjerët janë për, nuk ka nevojë, të gjithë të tjerët jemi për. 95 deputetë, tash vetëm ta marr gjendjen.

13 janë kundër, 4 abstenime, 78 për. Prapë nuk kalon. 78 janë për, nuk kalon.

Unë po vazhdoj me pikat e radhës, pastaj edhe një herë në fund e vej në votim.

**- Shqyrtimi i Projektligjit numër 06/L-098 për ratifikimin e Marrëveshjes për huan ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e autostradës Prishtinë-Pejë, segmenti Kijevë-Zahaq**

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni FunkSIONAL për Buxhet e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e kësaj Marrëveshje për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e kësaj autostrade dhe e ka rekomanduar për miratim.

Ministri i Financave, zoti Bedri Hamza, e ka fjalën, ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

S'ka nevojë, po shoh s'ka nevojë, po e marrim të mirëqenë. As komisioni nuk ka nevojë, as grupet parlamentare.

Po shkojmë drejt në votim, me aq sa po shoh, unanimitet i plotë, më duket dua t'ua uroj Kijevës e Zahaqit menjëherë.

Regjia dhe deputetë të përgatitemi për votim, nuk ka asnjë amendament për votim. 95 deputetë janë në sallë, votojmë tash në mënyrë elektronike.

Shumë urime vërtet qytetarëve të Pejës e krejt Kosovës!

Kuvendi e miratoi Ligjin numër 06/L-098 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime dhe projektin e autostradës Prishtinë-Pejë, segmenti Kijevë-Zahaq. Të gjithë bashkë, shkoi tash, të gjithë deputetët kanë votuar.

**- Shqyrtimi i Projektligjit numër 05/L-112 për ratifikimin e Marrëveshjes për financim mes Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për projektin e ekonomisë digjitale të Kosovës**

Edhe këtë projektligj komisioni i ka rekomanduar miratimin e tij, po shoh deputetët po thonë se ministri nuk ka nevojë ta paraqesë, po shkojmë drejt në votim, ka një unanimitet në këtë projektligj.

96 deputetë janë, regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, s'ka amendamente, votojmë tash në tërësi projektligjin.

Faleminderit! Ka edhe deputetë me dorë, Driton Selmanaj edhe Mimoza Kusari Lila, edhe paraprakisht kanë qenë njëjtë, të futen në pjesën e votimit edhe tash.

Do të thotë 89 deputetë kanë votuar, 89 për, asnjë kundër dhe abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin numër 05/L-112 për ratifikimin e Marrëveshjes për Financim mes Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për projektin e ekonomisë digjitale të Kosovës.

E kemi edhe një pikë.

**- Shqyrtimi i Projektligjit numër 05/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës lidhur me Programin mbështetës për ujësjellës dhe kanalizim në zonat rurale, Faza VI**

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa na ka rekomanduar ta miratojmë këtë projektligj, ministri i Financave, po shoh deputetët, nuk kanë nevojë ta paraqesë për arsye se ka dakordancë, edhe komisioni, s'ka deputetë të paraqitur.

97 deputetë janë, shkojmë drejtpërdrejt në votim, është vetëm një amendament, shkojmë me dorë.

Kush është kundër, për amendamentin e propozuar nga Komisioni Funkcional? Asnjë nuk është kundër. Abstenim nuk ka.

Me 96 deputetë kalon amendamenti 1.

Atëherë, shkojmë me votimin e projektligjit në tërësi me amendamentin e miratuar.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!



90 deputetë kanë votuar, 90 për, dy me dorë, do të thotë 88 janë në mënyrë elektronike. Kuvendi e miratoi Ligjin numër 05/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës, e falënderojmë.

**- Shqyrtimi i Projektligjit numër 06/L-102 për ratifikimin e Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin 'Evropa kreative' për mbështetjen e sektorëve kulturorë dhe kreativë**

Komisioni Funkcional për Arsim na ka rekomanduar ta miratojmë, po shoh ministrin nuk ka nevojë ta paraqesë, se ka unanimitet, as komisioni, nuk ka të lajmëruar për diskutim.

Shkojmë votimin në tërësi, nuk ka asnjë amendament.

Regjia dhe deputetët, votojmë tash:

91 deputetë kanë votuar, të gjithë janë për, edhe dy votat e deputetëve Driton Selmanaj edhe Mimoza Kusari-Lila, për 93. Atëherë, aprovohet me unanimitet Projektligji numër 06/L-102 për ratifikimin e Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin 'Evropa kreative' për mbështetjen e sektorëve kulturorë dhe kreativë.

Në këtë mënyrë kisha pasur dëshirë ta kemi edhe një rezolutë bashkë për dialogun për Serbinë me unanimitet.

A e fus edhe një herë në votim, na mbeti një, ReSPA, edhe një herë, apo hiç, si të doni?

Po shoh që nuk ka unanimitet, tri herë e kam vendosur në votim.

Kjo seancë mbyllet, vazhdojmë menjëherë me seancën parlamentare. Faleminderit!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*